



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 15. 09. 2011, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi,
Kymete Bajraktari, Biserka Kostiq dhe Duda Balje.

Munguan: Ismet Beqiri, Albana Gashi dhe Justina Pula.

Pjesëmarrëse të tjerë: Lejla Selimi- OSBE, Nehat Dervishi-OSBE dhe Ukë Gashi-
ZPRK .

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi -
zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali – kryetare, e cila konstatoi se në bazë të
Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e
mbledhjes dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Marrja e qëndrimit për përzgjedhjen e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të
Popullit;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Marrja e qëndrimit për përzgjedhjen e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit.

Kryetarja – Pas intervistimit për përzgjedhjen e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit, i ka propozuar Kuvendit të Kosovës, listën për miratim me 5 emra të kandidatëve si vijon: Basri Berisha, Isa Hasani, Bogoljub Staletoviq, Shqipe I. Malaj dhe Ibrahim Arslan. Ajo tha se Paneli rekrutues i Komisionit ka proceduar listën nga 27 kandidatë për zëvendës të Avokatit të Popullit në pajtueshmëri me rregullat e procedurës për përzgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, si dhe Ligjit për Avokatin e Popullit. Ajo shtoi se nga përzgjedhja e kandidatëve nga peneli intervistues i Avokatit të Popullit, shihet se është respektuar përbërja etnike, por jo struktura gjinore, prandaj ka shkelje të rregullave dhe të procedurave . Lidhur me këtë, debatuan edhe anëtarët e Komisionit.

Rita Hajzeraj – Unë mendoj se ai panel i propozuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit për intervistim, ka bërë shkelje të rregullores sepse intervistimi i kandidatëve është bërë në dy ditë, që do të thotë se kandidatët e ditës së dytë kanë mundur t'i dinë pyetjet dhe të jenë shumë më të favorizuar se kandidatët e ditës së parë. Mendoj se këtu është bërë shkelja më e madhe, dhe është bërë shkelje edhe në respektimin e barazisë gjinore, kështu që unë mendoj që t'i kthehet përgjigjja Institucionit të Avokatit të Popullit që nuk e pranojmë këtë përzgjedhje dhe mënyrën e intervistimit, dhe se edhe njëherë duhet të kthehet procedura nga fillimi.

Kymete Bajraktari- Duke u ndërlidhur rreth procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, bëri pyetje: kandidatët që janë propozuar, a janë intervistuar të gjithë në ditën parë apo ditën e dytë? Pra, nëse janë të gjithë të intervistuar gjatë ditës së dytë, jam e pajtimit me parafolësen se ata kanë mundur t'i marrin pyetjet dhe të përgjigjen shumë më mirë se kandidatët e ditës së parë.

Biserka Kostiq - Pajtohet me diskutimin e Rita Hajzerit dhe shtoi se pyetjet e kandidatëve, të bëra nga paneli intervistues, janë të përsëritura gjatë dy ditëve të intervistimit.

Si çështje të dytë e ngriti funksionimin e Komisionit rreth përzgjedhjes së kandidatëve, ka qenë vetëm çështje teknike, gjë që nuk është pajtuar. Ajo pati vërejtje në kandidatin e komunitetit serb, Bogoljub Satletoviq dhe tha se nuk ka informacione ajo dhe partia, dhe pyeti, se kush është ky njeri të cilin as komuniteti i saj nuk ka dijeni. Ajo tha se qëndrimi i partisë është që të gjedhet kandidati që mbron interesat e partisë dhe të komunitetit tim dhe mendoj se kandidati i propozuar, nga grupi im parlamentar nuk do të votojë .

Edhe pse Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij, kandidati është dashur që të kontaktojë me grupin parlamentar rreth përzgjedhjes së tij, prandaj nuk mund të marr me mend që vet Avokati i Popullit të bëjë përzgjedhjen e zëvendësve të tij, sepse mund të bëjë shkeljen e të drejtave dhe përgjegjësi të tij. Meqë ajo pati vërejtje rreth kandidatit, duke theksuar se nuk di se a është intervistuar ditën e parë apo të dytë, por po dihet se ai paska pasur një lidhje dhe ka mundur të kalojë nga paneli intervistues, prandaj kemi të drejtë që ta anulojmë konkursin dhe të kërkohet

përzgjedhja e serishme e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Si përfundim, ajo konstatoi se lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve është dashur të caktohet njeriu i cili disponon merita të posaçme, e jo të veprohet në këtë formë, dhe se ky nepotizëm po e dëmton zgjedhjen e njerëzve në pozitat e ndryshme nëpër institucionet e Kosovës.

Kryetarja - Edhe Raporti i Progresit kërkon që sa më shpejt të kryhet kjo procedurë e përzgjedhjes së zëvendësve dhe me siguri, Avokati i Popullit ka shkuar në atë drejtim që ne sa më shpejt t'i miratojmë këta emra dhe të kryhet kjo punë, sepse është e paraparë në Raport të Progresit.

Siç e theksova edhe me parë, me plot të drejtë, u shkelë Ligji për barazi gjinore, janë shkelur të drejtat e kandidatëve të ditës së parë në krahasim me ata të ditës së dytë. Intervistimi është dashur të kryhet për një ditë, mund të ndodh shkelje, por Institucioni i Avokatit të Popullit nuk duhet të lejojë një gjë të tillë, ne jemi Komision i ndjeshëm dhe vetë emri tregon se për çka jemi të thirrur dhe nuk guxojmë të lejojmë të shkelen procedurat dhe të drejtat e njeriut, unë jam që këto të drejta të mbrohen.

Krutan Kajtazi - Tha se më intereson kush janë anëtarët tjerë të panelit që kanë bërë intervistimin, në çka është thirrur për ta formuar këtë panel Avokati i Popullit, ai tha se Komisioni ka bërë një listë ku të gjithë anëtarët e partive politike që jemi të përfaqësuar në Komision dhe kemi menduar se ata janë kandidatët që i plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e intervistimit, ne nuk jemi ata që mund t'i caktojmë se kush duhet të jetë në listën përfundimtare, po së paku është dashur t'i përmbahet listës. Ai tha se kemi informata se kandidatët e ditës së dytë kanë qenë shumë më të gjindshëm se kandidatët e ditës së parë, pajtohem me atë që thanë parafolëset e mia, se janë shkelur procedurat dhe është shkelur ligji, ndërsa i përgjigjem Biserkës se Zëvendësavokatët e Popullit nuk mbrojnë interesa të caktuara të individëve, grupeve apo etnive të caktuara, por i mbrojnë interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, feje e gjinie, dhe se kandidati serb është aty për t'i mbrojtur interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, ndërsa sa i përket se çka të ndërmarrim më tej, ne si Komision duhet të procedojmë për Kryesi rekomandimin me vërejtjet tona se ku janë bërë shkeljet.

Kryetarja- Tha se këta pesë emra të dërgohen në Kryesi të Kuvendit me propozimin tonë, që do të përmbajë njoftim se janë shkelur rregullat procedurale sa i përket intervistimit që është kryer në dy ditë, është shkelur Ligji për barazi gjinore, neni 3, pika 3.1 e 3.2 dhe neni 3 në përgjithësi, është shkelur Ligji për Avokatin e Popullit, neni 8.2 dhe duhet të bëhen rekomandimet e Komisionit që ky konkurs duhet të anulohet për shkak të shkeljeve esenciale të procedurave dhe Ligjit.

Përfundim

Komisioni në mënyrë unanime vendosi që të bëjë rekomandimin për Kryesi të Kuvendit lidhur me rregullat procedurale që janë shkelur, ku gjatë intervistimit dyditor, në ditën e dytë, kandidatët kanë qenë më të përgatitur, gjithashtu është shkelur neni 3 i Ligjit për barazi gjinore dhe neni 8.2 i Ligjit për Avokatin e Popullit.

3. Të ndryshme.

Nuk pati çështje për t'u shqyrtuar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali